



Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .09.2021

*Lënda: Kriteret e aplikimit dhe nevojat për personel akademik të ftuar në Departamentin e Inxhinierisë Informatike për vitin akademik 2021-2022.*

Departamenti i Inxhinierisë Informatike, në zbatim të Vendimit të Rektorit Nr. 116, datë 22.09.2021 "Për miratimin e procedurës së punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme në UPT", ju përcjell kriteret e aplikimit për personel akademik me kohë të pjesshme në Departamentin e Inxhinierisë Informatike për vitin akademik 2021-2022, dokumentacionin që kandidatët për personel akademik me kohë të pjesshme duhet të dorëzojnë pranë Departamentit të Inxhinierisë Informatike dhe nevojat që Departamenti i Inxhinierisë Informatike ka për personel akademik me kohë të pjesshme.

- I. Dosja që do të dorëzojë kandidati, duhet të përmbajë, dokumentat si më poshtë:
  1. Kërkesë me shkrim për aplikim. (Stafi akademik me kohë të pjesshme i cili angazhohet rishtas në FTI duhet të sjellë vetëm kërkesën me shkrim dhe mund t'i shtojë dosjes çertifikata të cilat i ka fituar gjatë vitit të fundit)
  2. CV e kandidatit;
  3. Fotokopje e ID;
  4. Fotokopje e noterizuar e diplomës Bachelor në Inxhinieri Informatike dhe Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike në FTI, UPT ose të diplomave ekuivalente me to, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
  5. Listë e noterizuar e notave e studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave, ose i studimeve të ekuivalentuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi; Nota mesatare e ponderuar për të dy ciklet e studimit së bashku  $\geq 7.5$ , është kusht detyrues hyrës;
  6. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton titujt dhe gradat, trajnime, kualifikime, etj. (nëse ka);
  7. Dy rekomandime nga staf akademik i FTI, UPT, ose Universiteti/Fakulteti ku kandidati ka kryer studimet, me titull Profesor ose Prof. Asoc;
  8. Leje me shkrim nga titullari i institucionit/kompanisë ku është i punësuar, që lejon angazhimin e kandidatit në mësimdhënie si pedagog i ftuar në FTI, UPT për vitin akademik 2020-2021.
  9. Formular vetëdeklarimi sipas shtojcës bashkëngjitur.
- II. Skeda pikëzuese e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve do të përmbajë këto fusha kryesore:
  1. Diploma Bachelor/Master i Shkencave, në FTI/UPT ose në Fakultete Inxhinierike jashtë shtetit (me ekuivalencat përkatëse në MAS) ose në Fakultete Inxhinierike që i përkasin Universiteteve Shtetërorë brenda vendit, sipas formimit të kërkuar specifik. 0 - 10 pikë;
  2. Nota mesatare e ponderuar për Ciklet Bachelor dhe Master i Shkencave të marra së bashku. Nota më e ulët mesatare e pranuar do të jetë e njëjtë me prapen e vendosur nga Senati Akademik për rekrutimet e stafit të brendshëm akademik. 0 - 20 pikë;
  3. Çertifikata e mbrojtjes së gjuhës Angleze dhe pikët/vlerësimi përkatës. 0 - 10 pikë;



4. Kualifikime apo trajnime të tjera, të lidhura me formimin akademik apo fushat ku kandidati kërkohet të mbulojë, të provuara më çertifikata apo diploma përkatëse, të njohura/ekuivalentuara sipas legjislacionit Shqiptar. 0 - 10 pikë;
  5. Eksperienca e mëparshme në mësimdhënie në FTI/UPT apo në Universitete shtetërore brenda vendit, apo në Universitete jashtë vendit. Kjo duhet të provohet me vërtetime zyrtare të lëshuara nga institucionet përkatëse dhe të njohura/ekuivalentura sipas legjislacionit Shqiptar. 0 - 10 pikë;
  6. Artikuj të pranuar në konferenca apo simpoziumeve kombëtare/ndërkombëtare (që janë vlerësuar dhe rishikuar nga bordi editorial i konferencës/simpoziumit) dhe janë botuar në proceedings (me ISBN). 0 - 10 pikë;
  7. Artikuj të pranuar për botim/botuar në revista shkencore kombëtare/ndërkombëtare (me ISBN) me bord editorial, të cilat janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak. 0 - 10 pikë;
  8. Artikuj të pranuar për botim/botuar në revista shkencore kombëtare/ndërkombëtare (me ISBN) me bord editorial dhe me faktor impakti. 0 - 10 pikë;
  9. Grada shkencore Doktor. 30 pikë;
  10. Tituj Akademike Prof. Asoc, ose Prof. 30 pikë.
- Maksimumi i pikëve sipas këtij vlerësimi është 150 pikë.

III. Gjeni ju lutem më poshtë, nevojat e Departamentit të Inxhinierisë Informatike për personel akademik të ftuar, në Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve, për lëndët që mbulohen nga DII në FTI:

❖ **Bachelor në Inxhinieri Informatike**

Nr	Semestri I-rë Bachelor në Inxhinieri Informatike / Emërtimi i lëndës	Kreditet përkatëse (K)
1	Elementet e Informatikës	2 K Seminar (8 grupe) 0.5 K laborator (8 grupe)
2	Programimi i Orientuar nga Objekti	1.5 K seminar, 0.5 K laborator (4 grupe)
3	Arkitektura e Kompjuterave	0.5 K laborator (8 grupe)
4	Rrjetat e kompjuterave	1.5 K seminar, 0.5 K laborator (3 grupe)
5	Sisteme operative	1.5 K seminar, 0.5 K laborator (3 grupe)

Nr	Semestri II-të Bachelor në Inxhinieri Informatike / Emërtimi i lëndës	Kreditet përkatëse
1	Teknikat dhe gjuhët e programimit	2 K Seminar (8 grupe) 0.5 K laborator (8 grupe)
2	Algoritëm e programim i avancuar	2 K Seminar + 0.5 K laborator (4 grupe)
3	Arkitektura e Kompjuterave	0.5 K laborator (4 grupe)



4	Strukture te dhenash	0.5 K Laborator (4 grupe)
5	Programim në ambjentet e shpërndara	3.5 K Leksion
6	Legjislacion ne TIK	2 K Leksion, 0.5K seminar, 0.5K laborator (3 grupe)

❖ **Master Profesional në Inxhinieri Informatike**

Nr	Semestri I &II-të, Master Profesional në Inxhinieri Informatike / Emërtimi i lëndës	Kreditet përkatëse
1	Menaxhimi i Projekteve Softuerike	1.5K seminar, 1K laborator, 0.5K detyrë
2	Aplikacione mobile	3 K Leksion, 1.5 K seminar, 1 laborator, 0.5K detyrë
3	Zhvillime në web	3 K Leksion, 1.5 K seminar, 1 laborator, 0.5K detyrë
4	Teknologjia e Bazave të të dhënave në Oracle	1.5 K seminar, 1 laborator, 0.5K detyrë

❖ **Master Shkencor në Inxhinieri Informatike**

Nr	Semestri I &II-të , Master Shkencor ne Inxhinieri Informatike / Emërtimi i lëndës,	Kreditet përkatëse
1	Gjuhët dhe kompilatoret	4K leksione
2	Inteligjenca artificiale	3K leksione, 1K seminar, 1K Laboratore, 1K Projekt

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Dr. Enida Sheme**

**Shtojce**



## FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

<u>Mbiemri, Emri</u>	
<u>Atësia/Amësia</u>	
<u>Datëlindja</u>	
<u>Vendlindja</u>	
<u>Dokumenti i identifikimit</u> <small>(në kopje hashkëngjitur formularit)</small>	

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:  i/e padënuar.  i/e dënuar

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

Emër Mbiemër / Firmë

Emër Mbiemër / Firmë / Vule

**Autorizim:** Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga \_\_\_\_\_.

Subjekti i autorizuar

Nënshkrimi i deklaruesit autorizues

Data e nënshkrimit

*Shënim:* Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 8517 datë 22.07.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pasigjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

